




- Të reja ▾
- Kush jemi ▾
- Historiku
- Shërbime ▾
- Baza ligjore
- Vendndodhjet
- Video
- Programi i transparencës ▾
- Kontakt
- Denonco Krimin Kibernetik
- Drejtoritë Vendore ▾
- Policia Kufitare ▾
- Policia Rrugore ▾
- Donacione
- Policimi në Komunitet
- Përmbledhja Mujore
- Për sinjalizimin
- Të Guximshëm pa Armë

Breaking News: Durrës/Monitorim intensiv, me pajisje inteligjente, në akset rrugore dhe në pikat hyrëse dhe dalëse



09/06/2026

DVP Korçë/Finalizohet Operacioni I Koduar "Dishnica"

DVP Korçë

Finalizohet nga Seksioni për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve, në bashkëpunim me Sektorin e Forcës së Posaçme "Shqiponja", operacioni i koduar "Dishnica".

Qarkullonte me automjet, i armatosur me pistoletë, kapet në flagrancë dhe vihet në pranga 59-vjeçari, shtetas me rrezikshmëri shoqërore.

Shpallet në kërkim shtetasi që i ka shitur armën 59-vjeçarit.

Sekuestrohen 1 armë zjarri pistoletë me krehër me municion luftarak, 2 automjete dhe 1 celular.

Shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, në zbatim të planit të masave për kapjen e shtetasve që qarkullojnë me armë zjarri dhe/ose i mbajnë ato në banesë, pa leje, bazuar dhe në informacionet e siguruar në rrugë operative për një shtetas që qarkullonte i armatosur, finalizuan operacionin e koduar "Dishnica".

Gjatë operacionit, në aksin rrugor "Korçë-Devoll", shërbimet e Policisë ndaluan automjetin me drejtues shtetasin B. M., në të cilin, gjatë kontrollit, gjetën 1 armë zjarri pistoletë me krehër me municion luftarak.

Në vijim të veprimeve, u arrestua në flagrancë shtetas B. M., 59 vjeç, banues në fshatin Zëmbllak, Maliq, i dënuar më parë për veprat penale "Vrasja me dashje", kryer në bashkëpunim, "Vrasja me dashje", kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, dhe "Organizimi i lotarive të palejuara".

Gjithashtu, u shpall në kërkim shtetas G. A., 57 vjeç, banues në Korçë, pasi nga veprimet hetimore dyshohet se i ka shitur armën 59-vjeçarit.

Punohet për kapjen e shtetasit G. A. dhe për dokumentimin e plotë të veprimtarive kriminale të këtyre dy shtetasve.

Arma e zjarrit e sekuestruar do të dërgohet në Institutin e Policisë Shkencore, për të verifikuar nëse është përdorur ose jo në ngjarje të mëparshme kriminale.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Korçë, për veprime të mëtejshme.



Kërko



Komisariati Dixhital

GET IT ON



Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Durrës/Monitorim intensiv, me pajisje inteligjente, në akset rrugore dhe në pikat hyrëse dhe dalëse

Shëngjin, Lezhë/Përfundon pa incidente UNUM Festival 2026 ▶